

**VEÇORITË KULTURORE – HISTORIKE TË RRAFSHIT TË  
DUKAGJINIT NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE**

**TEMA PËR TITULLIN**

**MASTER I SHKENCËS NË HISTORI TË KOHËS SË RE**

**NGA**

**DREN BRAHIMAJ**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**

**FAKULTETI FILOZOFIK**

**DEPARTAMENTI I HISTORISË**

**PRISHTINË**

**SHKURT, 2023**

## REZYME PËR TEMË TË DIPLOMËS

**MENTORI:** PROF. ASOC. DR. MUHAMET QERIMI

Studimi i temës “*Veçoritë kulturore – historike të Rrafshit të Dukagjinit ndërmjet Dy Luftërave Botërore*”, ka për qëllim trajtimin e njëres prej periudhave më të vështira për popullin shqiptar. Menjëherë pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, Kosova dhe viset e tjera shqiptare ripushtohen nga ushtria serbe në fund të vitit 1918. Nën regjimin e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene të drejtat e shqiptarëve ishin skajshmërisht të shkelura. Kjo ndikoi që të forcohej Lëvizja Nacionalçlirimtare dhe gradualisht të masivizohej në të gjitha viset shqiptare të cilat ishin nën sundimin jugosllav. Ndërsa në aspektin politik, shqiptarët u munduan që nëpërmjet partisë së Xhemjetit t’i përçojnë në parlamentin e Mbretërisë SKS, të gjitha padrejtësitë dhe shtypjen e vazhdueshme që iu bënin autoritetet shtetërore. E Rrafshi i Dukagjinit si rajon kufitar me Shqipërinë, u pa me një interes të veçantë nga Beogradi, kjo për arsye të implementimit të projektit të saj për kolonizimin e viseve shqiptare me sllavë. Ndërprerja e shtrirjes homogjene të shqiptarëve të viseve Lindore me shtetin shqiptar mund të realizohej pikërisht nëpërmjet Rrafshit të Dukagjinit.

Punimi është i ndarë në pesë krerë. Në secilin prej tyre është shtjelluar në mënyrë të posaçme karakteristikat e kësaj periudhe historike.

Në kreun e parë, trajtojmë aspektet fiziko – gjeografike të Rrafshit të Dukagjinit, duke japur një pasqyrë shtrirjes gjeografike të kësaj krahine, si dhe relievit e lumenjëve të saj. Drini i Bardh si lumi më i madh, përshkron viset nga Peja në drejtim të Prizrenit e tutje në drejtim të Adriatikut. Gjatë rrjedhës së tij, lumi i Drinit të Bardhë mbledhë të gjitha degët e majta dhe të djathta të lumenjëve më të vegjël të Rrafshit të Dukagjinit. Kjo i mundëson që toka përgjatë rrjedhës së Drinit të jetë pjellore, njëkohësishtë përmes tij të depërtoj edhe klima mesdhetare. Aspekti territorial ka ndikuar që në Rrafshin e Dukagjinit të krijohen disa krahina më të vogla etnografike, të cilat me veçantit dhe karakteristikat e tyre në veshje, traditë, kulturë, doke, zakone, gjuhë, etj, plotësojnë etnokulturën e përgjithshme shqiptare. Veçori tjetër që vërehet edhe sot e kësaj dite është edhe arkitektura e Rrafshit të Dukagjinit, sidomos kullat dhe banesat qytetare të cilat vazhdojnë të ruhen.

Në kreun e dytë, do të flasim për ripushtimin serb të Kosovës dhe instalimin e administratës së regjimit të Mbretërisë SKS. Reprezaljet ndaj shqiptarëve që ndërmorrën autoritetet shtetërore

jugosllave menjëherë pasi morën nën kontrollë viset shqiptare, ndikuan në rritjen e Lëvizjes Nacionalçlirimtare në këto treva. Çetat kryengritëse shqiptare nën drejtimin e Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës vazhduan rezistencën gjatë gjithë periudhës së parë dhjetë vjeçare të sundimit të Mbretërisë SKS. Por, shqiptarët u munduan që edhe nëpërmjet rrugëve legale, përfaqësimit në parlament të evokojnë të drejtat e mohuara të tyre.

Në kreun e tretë, shtjellojmë legjislacionin e reformës agrare, duke njohur më në detaje dekretligjet dhe ligjet që nxorën autoritetet monarkiste të Beogradit. Përmes ligjit agrarë, serbët synuan dhe punuan që të bëhej kolonizimi i viseve të ashtuquajtura Jugore të banuara kryesisht në përqindje më të lartë me shqiptarë, me kolonë sllavë. Kolonizimi shihej nga regjimi jugosllav si mundësia më e mirë dhe më e shpejtë për arritjen e shpërnguljes definitive të shqiptarëve, qoftë në drejtim të Shqipërisë apo Turqisë. Shpërngulja do mundësonte ndërrimin përfundimtar të raporteve mes popullsisë shumicë shqiptare në trevat e tyre me popullsinë sllave.

Në kreun e katërt, njihemi me rrethanat e përgjithshme politike të shkaktuara nga vendosja e diktaturës së Aleksandrit, më 6 janar 1929. Diktatura e vendosur nga mbreti shkaktoj shpërndarjen e parlamentit, suprimimin e kushtetutës së vitit 1921, e ndalimin e veprimtarisë politike të partive. Kjo kohë u shfrytëzua edhe për përndjekjen e figurave kyçe të çështjes shqiptare, siq ishte rasti i vrasjes së At Shtjefën Gjeçovit, më 14 tetor 1929. Një hapje më e madhe u bë, vetëm pas aprovimit të kushtetutës së vitit 1931. Shumë shpejtë jetën politike të Mbretërisë Jugosllave do e merrte nën kontrollë partia JRZ, e cila shtriu ndikimin e saj edhe në Kosovë e gjetkë. Shqiptarët vazhdonin të mbeteshin të shtypur gjatë gjithë kohës ndërmjet viteve 1918-1941.

Në kreun e pestë, shohim sesi autoritetet jugosllave mbyllën të gjitha shkollat shqipe që ishin hapur në kohën e Perandorisë Austro-Hungareze. Në gjitha viset shqiptare u hapën shkolla shtetërore, të cilat obligonin mësimin e gjuhës zyrtare shtetërore. Jo vetëm në aspektin arsimor, shqiptarët mbetën mbrapa, por edhe në atë ekonomik. Viset shqiptare vazhduan të mbeteshin rajoni më i prapambetur ekonomik. Krejt në fund do njihemi me planprogramet serbe kundër shqiptarëve, të ashtuquajturin “*Klubi Kulturor Serb*”, si dhe përmbajtjen e konventës jugosllavo-turke.

Në fund të këtij punimi do të jepet edhe një përfundim i shkurtër në lidhje me këto ngjarje të trajtuara